

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT
MASTER I SHKENCAVE NË ARKITEKTURË - PROFILI URBANIST
DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS, FAU, UPT**



2022 - 2023

Përmbajtja

KREU I. BAZA LIGJORE	4
Neni 1. <i>Baza ligjore e rregullores së programit të studimit</i>	4
Neni 2. <i>Objektivi, qëllimi dhe fusha e veprimit të rregullores</i>	4
KREU II. PROGRAMI I STUDIMIT	4
Neni 1. <i>Emërtimi dhe lloji i programit</i>	4
Neni 2. <i>Departamenti përgjegjës dhe strukturat bashkëpunuese</i>	4
Neni 3. <i>Koordinatori i programit</i>	5
Neni 4. <i>Kohëzgjatja e studimeve</i>	5
Neni 5. <i>Objektivat formuese të programit të studimit</i>	5
Neni 6. <i>Njohuritë dhe kompetencat në dalje</i>	5
Neni 7. <i>Kreditë</i>	6
Neni 8. <i>Plani mësimor</i>	6
Neni 9. <i>Programet mësimore të lëndëve</i>	6
Neni 10. <i>Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese</i>	7
Neni 11. <i>Kriteret e pranimit</i>	9
KREU III. ORGANIZIMI I STUDIMEVE	10
Neni 1. <i>Viti akademik</i>	10
Neni 2. <i>Grupi mësimor</i>	10
Neni 3. <i>Format e mësimdhënies</i>	10
Neni 4. <i>Format e provimeve dhe verifikimi i dijeve</i>	11
Neni 5. <i>Lëndët e studios së projektimit / atelie</i>	12
Neni 6. <i>Vlerësimi ose shlyerja e studios së projektimit / atelie</i>	12
Neni 7. <i>Detyrime frekuentimi</i>	13
Neni 8. <i>Kalimi në vitin pasardhës</i>	13
Neni 9. <i>Përmirësimi i notës</i>	14
KREU IV. ORGANIZIMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE	14
Neni 1. <i>Praktika profesionale</i>	14
KREU V. MODALITETE PËR TRANSFERIMIN E STUDENTËVE	15
Neni 1. <i>Transferimi i studimeve</i>	15
Neni 2. <i>Njohja e krediteve për procese mësimore jashtë programit të studimit</i>	15
KREU VI. DIPLOMIMI	15
Neni 1. <i>Procedurat</i>	15
Neni 2. <i>Parakushte të marrjes së temës së Diplomës</i>	16
Neni 3. <i>Aspekte didaktike</i>	16
Neni 4. <i>Punimi i diplomës</i>	16



Neni 5. <i>Udhëheqja e temës së diplomës</i>	17
Neni 6. <i>Detyrimet përmbyllëse të Diplomës</i>	17
Neni 7. <i>Kontrollet e ndërmjetme në Atelienë e Diplomave dhe përmbajtja e tyre</i>	18
Neni 8. <i>Mbrojtja e diplomës</i>	18
Neni 9. <i>Organizimi i mbrojtjes së diplomës</i>	19
Neni 10. <i>Vlerësimi i punimit</i>	19
KREU VII. <i>ANKIMIMI</i>	20
Neni 1. <i>Ankimimi</i>	20
KREU VIII. <i>DISPOZITA TË FUNDIT</i>	20
ANEKS 1. <i>PLANI MËSIMOR</i>	21
ANEKS 2. <i>EKUIVALENTIME</i>	23
ANEKS 3. <i>FORMULARË APLIKIMI STUIO DIPLOME, D1, D2</i>	28
ANEKS 4. <i>FORMAT VLERËSIMI UDHËHEQËSI I DIPLOMËS</i>	31

KREU I. BAZA LIGJORE

Neni 1. *Baza ligjore e rregullores së programit të studimit*

1. Rregullorja mësimore e programit të integruar të studimit “*Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*” mbështetet në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në aktet nën-ligjore në zbatim të tij, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës si dhe në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Neni 2. *Objektivi, qëllimi dhe fusha e veprimit të rregullores*

1. Kjo rregullore mësimore e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij.
2. Kjo rregullore përcakton aspektet organizative të programit të studimit. Ajo është hartuar duke respektuar lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve.
3. Kjo rregullore zbatohet nga i gjithë personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në Departamentin e Urbanistikës si dhe studentët e programit të studimit “*Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*” dhe ndihmon në menaxhimin e procesit mësimor.

KREU II. PROGRAMI I STUDIMIT

Neni 1. *Emërtimi dhe lloji i programit*

1. Ky program studimi emërtohet “*Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*” dhe është program i integruar i ciklit të dytë, referuar nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ky program ofrohet vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë. Ky program përmbillet pas përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në planin mësimor dhe fitimit të 300 krediteve (ECTS). Në përfundim të tij lëshohet diplomë “*Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*”
2. Programi ofrohet në gjuhën shqipe. Studentët e huaj që duhet të ndjekin programin e studimit, duhet të dëshmojnë njohjen e kësaj gjuhe në nivelin e nevojshëm dhe sipas marrëveshjes ndërmjet dy institucioneve.

Neni 2. *Departamenti përgjegjës dhe strukturat bashkëpunuese*

1. Njësia bazë përgjegjëse e cila ofron programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “*Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*” është Departamenti i Urbanistikës, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, UPT.
 2. Ky program studimi organizohet në bashkëpunim me departamentet e tjera të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës: Departamenti i Arkitekturës, Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës.
- Në këtë program studimi kontribuojnë dhe Departamente nga Fakultete të tjera, të cilat mbulojnë fusha të ndryshme të ekspertizës, si: Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike e Inxhinierisë Fizike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Qendra e Gjuhëve të Huaja.

Neni 3. *Koordinatori i programit*

Koordinatori i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me rezultatet e të nxënit të tij. Procedurat e përzgjedhjes, mandati dhe kompetencat e koordinatorit të programit të studimit përcaktohen në Rregulloren e Departamentit të Urbanistikës.

Neni 4. *Kohëzgjatja e studimeve*

1. Programi i studimit “*Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*” organizohet në 300 kredite, me kohëzgjatje normale në pesë vite akademike.
2. Studenti mund të përfundojë programin përkatës të studimeve edhe jashtë kohës normale të studimeve. Kohëzgjatja maksimale e studimeve nuk mund të jetë më shumë se dhjetë vite, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

Neni 5. *Objektivat formuese të programit të studimit*

Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “*Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*” synon formimin e profileve bashkëkohore të profesionistëve dhe studiuesve të rinj në fushën e arkitekturës, urbanistikës dhe mjedisit të ndërtuar, të aftë të përballen me sfidat që gjeneron konteksti Shqiptar, por edhe ato të një natyre më të gjerë si zhvillimi i qëndrueshëm apo sfidat e globalizimit. Për arritjen e këtij objektiv, gjatë viteve të studimit, studenti pajiset me njohuri shkencore e aplikative që lidhen me disiplinën e projektimit arkitektonik dhe urban.

Studimet e integruara të ciklit të dytë, *Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*, përfshijnë një sërë instrumentesh teorike në programin e studimit për të mundësuar te studentët marrjen e bazave të nevojshme shkencore, aftësi metodike kërkimore dhe kualifikimin profesional në fushën e *arkitekturës dhe urbanistikës*.

Programi i studimit ka si objektiv kryesor formimin e profesionistëve, të aftë të integrohen në tregun e punës duke shfaqur njohuri të plota në ballafaqimin me projektet arkitekturore, ndërhyrjet urbane, planifikimin dhe zhvillimet territoriale.

Programi mësimor është organizuar në mënyrë të tillë të gërshetojë sa më mirë njohuri specifike për një formim sa më të plotë për një profesion ndërdisiplinor, siç është figura e arkitektit dhe urbanistit. Në përfundim të këtij programi studimi, profesionisti i sapo diplomuar është në gjendje të analizojë probleme dhe të japë zgjidhje në terma hapësinore urbane dhe arkitektonike, përmes instrumentesh të shumtë.

Neni 6. *Njohuritë dhe kompetencat në dalje*

1. Në përfundim të ciklit pesë-vjeçar të studimeve në këtë program studimi studenti:
 - a. Fiton njohuri të thella në lëndët e formimit të përgjithshëm si arkitekt/urbanist, dhe të jetë në gjendje të përdorë këto njohuri për të interpretuar problemet në projektimin arkitektonik dhe urban.
 - b. Fiton njohuri të plota në bazat e vizatimit dhe projektimin arkitektonik, në kompozicion dhe analizë forme, në projektim urbanistik dhe urbanistike teknike, në materialet e ndërtimit dhe teknologjisë së tyre, njohuri lidhur me historinë dhe teorinë e arkitekturës dhe urbanistikës.
 - c. Merr njohuritë e nevojshme për të kryer punë kërkimore të pavarur, qoftë në funksion të problemeve të praktikës profesionale, qoftë në funksion të niveleve më të thelluara të studimeve.
 - d. Përvetëson rregullat e projektimit urban, ambiental, peizazhit, ekonomisë apo organizimit të punimeve, strategji mbi rivitalizimin urban, infrastrukturë dhe transport, planifikim territori, menaxhim urban, politika strehimi, etj.

e. Do të jetë në gjendje të realizojë Plane të Përgjithshme Vendore, Plane të Detajuara vendore sikurse edhe në koordinim me specialiste të tjerë si në fushat e arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit, gjeodezisë, mjedisit etj.

2. Zotëruesi i kësaj diplome, mund të punësohet si projektues arkitekt dhe urbanist (profesion i rregulluar) në ndërmarrje / organizata publike apo private. Kjo diplomë mundëson marrjen e liçensës profesionale, pa detyrim të kurseve të mëtejshme, duke ndjekur specifikimet në legjislacionin përkatës, bazuar në vite dhe eksperiencë pune.

3. Diploma e ciklit të dytë “Master i Shkencave” i jep mundësinë mbajtësit të saj për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë (studime doktorate).

Neni 7. *Krediti*

1. Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “*Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*” është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite (ECTS). Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student me kohë të plotë është 60 kredite.

2. Një krediti të formimit të arsimit të lartë i korrespondojnë 25 orë mësimore pune të studentit (1 orë mësimore pune llogaritet 50 minuta). Sasia mesatare e punës së kryer nga studentit gjatë një viti studimesh universitare me kohë të plotë është 1500 orë mësimore (60 kredite), që përfshijnë orë në auditor dhe orë punë të pavarur.

3. Orët e punës së pavarur të studentit, zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është nga 20 deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe.

4. Studenti fiton kreditet përkatëse për çdo veprimtari formuese si: lëndë, praktikë, diplomë, etj., vetëm në rastin e një vlerësimi pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tij. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar.

Neni 8. *Plani mësimor*

1. Plani mësimor i programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë “*Master i Shkencave në Arkitekturë - profili Urbanist*” pasqyron periudhën kohore të organizimit të secilës nga disiplinat dhe veprimtaritë formuese të programit, ngarkesën e tyre në ECTS (kredite), orë në auditor dhe orë pune individuale, të ndara sipas viteve akademike, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Në planin mësimor të çdo programi studimi përcaktohen:

i. lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra;

ii. kreditet përkatëse.

2. Plani mësimor i programit të studimeve miratohet çdo vit akademik nga Senati Akademik i UPT.

3. Plani mësimor i miratuar, për këtë vit akademik, gjendet në *Aneksin 1* në këtë rregullore.

4. Në rastin kur ndryshimi i Planit mësimor sjell ndryshime në emërtim/përmbajtje të programit të lëndës, njohja dhe ekuivalentimi i tyre i refererohet *Aneksit 2*.

Neni 9. *Programet mësimore të lëndëve*

1. Programet mësimore të lëndëve hartohen për çdo lëndë/modul të planit mësimor të programit të studimit. Në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, në programin e lëndës jepen në formë të përmbledhur:

- a. të dhënat e përgjithshme për lëndën, viti akademik, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e lëndës, struktura e lëndës sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor, emri i titullarit të lëndës dhe i stafit mësimdhënës;
- b. njohuritë paraprake që duhet të ketë fituar paraprakisht studenti, objektivat formuese të lëndës, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti nga përvetësimi i lëndës, konceptet dhe termat bazë mbi të cilat ndërtohet lënda;
- c. përmbajtja e lëndës, e ndarë në leksione dhe ushtrime/seminare, e detajuar në tematika që zhvillohen sipas javëve mësimore;
- d. përmbajtja e punëve laboratorike, praktikave lëndore, temat e detyrave/projekteve të kursit;
- e. forma e kontrollit që do të përdoret, parakushtet e hyrjes në provim, mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë dhe ajo ndihmëse

2 Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës ose grup lektorësh të lëndës, rishikohet nga Këshilli i Programit të Studimit në Departamentin e Urbanistikës për komente apo rekomandime dhe miratohet nga drejtuesi i departamentit dhe dekani i Fakultetit.

3 Programet mësimore të lëndëve janë objekt i rishikimit periodik, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies të UPT-së dhe në Rregulloren e Departamentit të Urbanistikës.

Neni 10. *Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese*

1. Në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “*Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*”, veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

A. *Lëndë bazë* të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;

B. *Lëndë karakterizuese*, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;

C. *Lëndë ndërdisiplinore* dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;

D. *Lëndë plotësuese*, të fokusuar në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;

E. *Detyrime përmbyllëse*, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.

2. Në planin mësimor, ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për: leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, është përcaktuar, në bazë të ndarjes së krediteve (ECTS) të lëndës për secilin komponent mësimor të saj dhe orëve që i caktohen çdo krediti, të miratuar nga Senati Akademik i UPT-së.

Tabela e mëposhtme jep veprimtaritë formuese sipas kategorive të mësipërme:

Kodi i lëndës	Lënda	Kategoria	ETCS
MT111AU	<i>Matematikë I</i>	A	3
GJ111AU	<i>Gjeometri deskriptive I</i>	A	5
VHA11AU	<i>Vizatim i lirë dhe histori arti</i>	A	6
GAR10AU	<i>Grafikë arkitektonike</i>	A	8

MT212AU	<i>Matematikë 2</i>	A	3
HA112DU	<i>Histori arkitekture 1</i>	A	6
GJ212AU	<i>Gjeometri deskriptive 2</i>	A	4
END12CU	<i>Elemente ndërtesash</i>	A	5
GC121AU	<i>Komunikim grafik - CAAD1</i>	A	3
HA221AU	<i>Histori arkitekture 2</i>	A	5
GC222AU	<i>Komunikim grafik - CAAD 2</i>	A	3
HA322AU	<i>Histori arkitekture 3</i>	A	3
FTK31AU	<i>Fizikë teknike</i>	A	6
<i>TOTAL kredite, kategoria A</i>			<i>60</i>
AQT11BU	<i>Analizë qyteti dhe territori</i>	B	4
BPA12AU	<i>Bazat e projektimit arkitektonik</i>	B	8
KFH20BU	<i>Kompozicion, analizë forme e hapësire</i>	B	8
SA121BU	<i>Studio arkitekture 1</i>	B	8
TA121BU	<i>Teknologji arkitekture 1</i>	B	5
SA222BU	<i>Studio arkitekture 2</i>	B	8
TA222BU	<i>Teknologji arkitekture 2</i>	B	5
BUP22BU	<i>Bazat e projektimit urban dhe elemente të peizazhit</i>	B	7
TAU31BU	<i>Teori arkitekture e urbanistike</i>	B	6
SA331BU	<i>Studio arkitekture 3</i>	B	8
TA331BU	<i>Teknologji arkitekture 3</i>	B	6
RAT32BU	<i>Rilevim arkitektonik dhe topografi</i>	B	4
SA432BU	<i>Studio arkitekture 4</i>	B	8
URB32BU	<i>Urbanistikë 1</i>	B	8
PMU40BU	<i>Projektim i mjedisit të ndërtuar</i>	B	8
HUR41BU	<i>Histori urbanistike</i>	B	6
PLT41BU	<i>Planifikim territori</i>	B	6
PU240BU	<i>Projektim urbanistik 2</i>	B	14
GJU41BU	<i>Gjeografi urbane</i>	B	3
TRI42BU	<i>Transport dhe Infrastrukturë</i>	B	6
MUR42BU	<i>Menaxhim urban</i>	B	4
ELP51BU	<i>Elemente peizazhi</i>	B	5
RUR51BU	<i>Rigjenerim Urban</i>	B	7
MKA51BU	<i>Metoda kërkimore të aplikuara në Urbanistikë</i>	B	4
PST51BU	<i>Politikat e strehimit - Housing</i>	B	5
<i>TOTAL kredite, kategoria B</i>			<i>161</i>
MND11CU	<i>Materiale ndërtimi</i>	C	3
SK121CU	<i>Shkencë konstruksioni 1</i>	C	5
SK231CU	<i>Shkencë konstruksioni 2</i>	C	4
IND32CU	<i>Impiante ndërtesash</i>	C	6
KN132CU	<i>Konstruksione ndërtimi 1</i>	C	4
LAU41CU	<i>Legjislacion arkitektonik e urban</i>	C	3
ETU42CU	<i>Ekonomi tregu dhe ekonomi urbane</i>	C	6
	<i>Lëndë me zgjedhje 1:</i>	C	4
Z1S42CU	<i>Sociologji urbane</i>		
Z1P42CU	<i>Politika urbane dhe territoriale</i>		
Z1K42CU	<i>Kërkim shkencor dhe etikë profesionale</i>		

FAQ51CU	Filozofi dhe antropologjia e qytetit	C	5
	Lëndë me zgjedhje 2:	C	5
Z2T52CU	Teori Bashkëkohore të urbanizimit		
Z2Q52CU	Qyteti bashkëkohor: ndryshimet dhe politikat sociale		
Z2U52CU	Hapësirat publike dhe dizajni urban		
TOTAL kredite, kategoria C			45
GJH11DU	Gjuhë e huaj	D	5
GIS51DU	Sisteme Informacioni (G.I.S)	D	4
PPR52DU	Praktikë profesionale	D	10
TOTAL kredite, kategoria D			19
DPL52EU	Diploma Urbanist	E	15
TOTAL kredite, kategoria E			15

3. Raportet e sasisë së krediteve të lëndëve sipas kategorive dhe përqindjet e tyre në raport me totalin e krediteve të planit mësimor në përputhje me kornizën ligjore në fuqi jepen në tabelën që vijon:

Kategoria	Nr. i lëndëve	Kredite ETCS	Përqindje në raport me totalin	% e lejuara sipas Legjislacionit në fuqi
A	13	60	20.0%	15 - 20%
B	25	161	53.7%	45 - 55%
C	10	45	15.0%	12 - 15%
D	3	19	6.3%	6 - 8%
E	1	15	5.0%	3 - 5%
		300	100%	

Tabela në vijim paraqet zbërthimin e kreditit sipas veprimtarive mësimore:

Aktiviteti	Nr. Krediteve	Cikli i dytë MSc	
		Orë auditor	Orë stud. indiv
Leksion	1 kredit	10	15
Ushtrime/Studio	1 kredit	12	13
Laborator	1 kredit	20	5
Projekt/detyra	1 kredit	5	20
Praktika	1 kredit	20	5
Diploma	1 kredit	5	20

Neni 11. Kriteret e pranimit

1. Për t'u pranuar në programin e studimit, studenti duhet të ketë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ose zotëron një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar dhe njehsuar nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, si ekuivalente me të dhe që plotëson kriteret shtetërore, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

2. Në këtë program studimi pranohen edhe kandidatë të cilët kanë një diplomë universitare të fituar në një institucion të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit dhe kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi. Në rastet kur studenti kërkon njohje të krediteve, procesi i njohjes dhe vlerësimit të programit të studimit bëhet nga Departamenti i Urbanistikës.

3. Numri maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre,

përcaktohen me vendim të Senatit Akademik dhe bëhen publike çdo fillim viti akademik, para fillimit të regjistrimeve.

4. Kriteret e aplikimit dhe pranimit përcaktohen në “Rregulloren mbi pranimet në Programet e Integruara të ciklit të dytë të studimeve Master i shkencave në Arkitekturë në profilin Arkitekt, Master i Shkencave në Arkitekturë, në profilin Urbanist dhe në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn”.

KREU III. ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 1. Viti akademik

1. Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “*Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*” zhvillohet në vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin e lartë. Viti akademik përfshin mësimdhënien, sesionin e provimeve, sesionin e mbrojtjes së diplomave. Mësimdhënia organizohet në dy semestra. Për vitin I, II dhe III kohëzgjatja e semestrit është 14 javë. Për vitin IV dhe V kohëzgjatja e semestrit është 12 javë.

2. Organizimi i mësimdhënies, i sesionit të provimeve dhe i sesionit të mbrojtjes së diplomave, shprehet në strukturën mësimore, e cila miratohet dhe shpallet nga Rektori i UPT-së në fillim të çdo viti akademik.

Neni 2. Grupi mësimor

2.1 Puna mësimore zhvillohet mbi bazë grupi mësimor. Numri maksimal i studentëve në grupet mësimore, në varësi të aktivitetit mësimor, respekton përcaktimet e rregullores së zhvillimit kurrikular të UPT-së, si më poshtë:

Nr. Studentë leksion	Nr. Studentë seminar	Nr. Studentë lëndët studio (FAU)	Nr. Studentë laborator	Nr. Studentë praktika
deri në 2 grupe seminari (50)	25	10 - 15	25	20

2. Numri minimal i studentëve për zhvillimin e një programi studimi është 10. Në raste të veçanta, me miratim të BAUPT, mund të organizohen grupe mësimore me numër më të vogël studentësh.

Neni 3. Format e mësimdhënies

1. Puna mësimore brenda këtij programi studimi zhvillohet konform formave të mësimit dhe të kontrollit të dijeve të përshkruara në Rregulloren e zhvillimit Kurrikular dhe të Mësimdhënies të UPT-së. Këto forma respektojnë raportet e caktuara në *Planet mësimore*, në *Programet e lëndëve* dhe në *Rregulloren mësimore të programit të studimit*. Në Universitetin Politeknik format kryesore të punës mësimore janë:

a. *Format e mësimit teorik dhe praktik*, ku përfshihen: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, studiot (atelië), projekt – diplomat, etj.

b. *Format e kontrollit të dijeve*, ku përfshihen: bashkëbisedimet, mbrojtje e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e lëndës, provimet e formimit, mbrojtje e temave e diplomave, etj.

2. Për këtë program studimi format e mësimdhënies janë si vijojnë:

- a. Seminar
 - b. Leksion
 - c. Studio (atelie)
 - d. Detyra kursi / Projekt kursi
 - e. Laborator
 - f. Praktikë Profesionale
 - g. Praktikë Lëndore
 - h. Punëtori (workshop) / projekte jashtë-kurrikulare në kuadër bashkëpunimesh
3. Format të tjera të mundshme alternative të mësimdhënies për këtë program studimi përshkruhen në Programet mësimore të lëndëve dhe propozohen e miratohen sipas procedurave të përshkruara në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT.

Neni 4. *Format e provimeve dhe verifikimi i dijeve*

1. Në këtë program studimi, për të vlerësuar njohuritë e studentit, përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Nota minimale kaluese është 5 (pesë).
2. Në rastin e organizimit të disiplineve me module, vlerësimi realizohet nëpërmjet provimit të integruar për të gjithë lëndën, ose shlyerjen me pjesë të lëndës sipas moduleve. Në të dyja rastet vlerësimi i tezës bëhet me pikë dhe vlerësimi përfundimtar do të shprehet nëpërmjet një note mesatare të ponderuar, ku merret në konsideratë pikët dhe kreditet për çdo pjesë të shlyer.
3. Në programin e lëndës / modulit shprehen mënyrat e vlerësimit të saj, të cilat i bëhen të njohura studentit me fillimin e procesit mësimor.
4. Format e kontrollit të dijeve të aplikuara në këtë program studimi janë si vijojnë:
 - a. Test i ndërmjetëm;
 - b. Kontroll në detyra / projekte;
 - c. Mbrojtja e projektit;
 - d. Provim / test me shkrim;
 - e. Provim me gojë.
5. Tezat e provimit hartohen nga lektori i lëndës dhe miratohen e nënshkruhen nga drejtuesi i departamentit.
6. Kushtet, modalitetet e zhvillimit si dhe pesha në vlerësimin përfundimtar të secilës formë kontrolli përcaktohen në Programin mësimor të lëndëve dhe miratohen sipas procedurave të përshkruara në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT.
7. Në rastet e verifikimit të dijeve nëpërmjet formës së provimit me shkrim, rregullat e zhvillimit i referohen përcaktimeve të *nenit 34* të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies UPT.
8. Studenti ka të drejtë të ankimohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim në sekretarinë e dekanit, brenda një afati prej 3 ditë pune nga shpallja e rezultatit.
9. Kjo ankesë shqyrtohet nga dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime drejtuesin e njësisë bazë përkatëse, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë, brenda tri ditëve pune.

10. Kur ankesa është e drejtë, dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të rivlerësohet ose të përsërisë provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë, dokumentohet.

Neni 5. Lëndët e studios së projektimit / atelie

1. Studio projektimi / atelie është një formë mësimdhënieje e aplikuar në lëndë me karakter thellësisht profesional e formues në këtë program studimi, ku instrumenti kryesor i dhënies dhe përcimit të dijes është projekti, si produkt final i një procesi, i cili imponon angazhim intelektual, teorik dhe praktik të studentit, nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e pedagogut.

2. Lëndët profesionale të tipit studio/atelie të cilat kanë detyrim frekuentimin dhe konsultimin për këtë program studimi, janë si vijon:

Nr.	Profili	Lënda
1	URB	Grafikë Arkitektonike
2	URB	Bazat e Projektimit Arkitektonik
3	URB	Vizatim i lirë dhe histori arti
4	URB	Teknologji Arkitekturë 1,2,3
5	URB	Bazat e projektimit urban dhe elemente të peizazhit
6	URB	Studio Arkitekturë 1,2,3,4
7	URB	Urbanistikë 1
8	URB	Projektimi i Mjedisit të Ndërtuar
9	URB	Planifikim territorial
10	URB	Projektim urbanistik 2
11	URB	Transport infrastrukture
12	URB	Elemente peizazhi
13	URB	Rigjenerim Urban
14	URB	Diploma Urbanist

Neni 6. Vlerësimi ose shlyerja e studios së projektimit / atelie

1. Vlerësimi përfundimtar në lëndët me karakter studio bazohet në katër komponentë:

a. Vlerësimi projektit të kursit

Vlerësimi i projektit të kursit, bazohet në ecurinë e punës së studentit gjatë realizimit të programit të lëndës si dhe në analizën dhe cilësinë e projektit përfundimtar. Gjatë procesit të projektimit gjatë një moduli, studenti do t'i nënshtrohet konsultimeve dhe kontrolleve, sipas programeve përkatëse, të cilat vlerësohen nga pedagogu i lëndës ose komisionet e ngritura. Vlerësimi pozitiv i kontrolleve është kusht i domosdoshëm për dorëzimin e projektit të kursit. Projekti i kursit dorëzohet me mbrojtje të hapur përballë jurisë / komisionit.

b. Vlerësimi i formimit teorik

Vlerësimi i formimit teorik, realizohet me anë të provimit me shkrim ose me gojë, gjatë ose pas dorëzimit të projektit të kursit dhe vlerësimit pozitiv të tij.

c. Vlerësimi i praktikës mësimore

Vlerësimi i praktikës realizohet me mbrojtje (shlyerje).

d. Frekuentimi dhe aktivizimi

Frekuentimi dhe aktivizimi vlerësohen mbi performancën e shfaqur nga studenti gjatë procesit mësimor.

2. Pesha e secilit komponent në raport me vlerësimin përfundimtar përcaktohet në Programet mësimore të lëndëve.

3. Nuk lejohet shlyerja e detyrimeve të lëndës përgjatë sesionit të provimeve.
4. Në qoftë se studenti plotëson 75% të frekuentimit, por nuk fiton të drejtën për të dorëzuar projektin kur nuk ka fituar kontrollet e ndërmjetme, shpallet përsëritës nga sekretaria mësimore dhe i shënohet emri në regjistrin e përsëritësve për vitin pasardhës.
5. Për studentet që realizojnë frekuentimin dhe kontrollet përkatëse të projektit dhe vlerësohen me notë jo kaluese (4 katër) në projekt, ose që nuk arrijnë të realizojnë dorëzimin e projektit në fund të modulit/lëndës, kanë të drejtë të bëjnë dorëzim deri në sezonin e provime në vjeshtë të vitit akademik pasardhës. Në rast se deri në këtë kohë studenti nuk shlyen projektin, atëherë studenti duhet të ndjekë dhe frekuentojë sërish lëndën.
6. Nuk lejohet që studenti të zhvillojë të njëjtin projekt në 2 vite të njëpasnjëshme në lëndët Studio.

Neni 7. *Detyrime frekuentimi*

1. Studenti duhet të ndjekë të gjitha format e mësimdhënies së disiplinave të përcaktuara në planin mësimor. Masa e detyrueshme e frekuentimit të tyre ndryshon në funksion të tipit të aktivitetit mësimor që realizohet, duke i klasifikuar pjesërisht të detyrueshme dhe plotësisht të detyrueshme.
 - a. Frekuentimi i leksioneve, i seminareve dhe ushtrimeve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 75% të numrit të seanceve të zhvilluara.
 - b. Frekuentimi i punëve laboratorike, punëve praktike dhe praktikave mësimore është plotësisht i detyrueshëm në masën 100%.
2. Për format e mësimimit me frekuentim të detyruar, të pjesshëm, kur studenti me ose pa arsye, nuk merr pjesë në mbi 25% të numrit të seanceve të zhvilluara në një lëndë, shpallet i paklasifikuar dhe nuk lejohet të shlyejë detyrimet e mëtejshme të asaj lënde. Ai është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimimit në vitin pasardhës, me të njëjtën detyrë frekuentimi.
3. Për formën e mësimimit me frekuentim të detyrueshëm laborator dhe praktikë mësimore / profesionale në terren, kur studenti me ose pa arsye nuk merr pjesë qoftë edhe në një seancë mësimi, departamenti përkatës i krijon studentit edhe një mundësi tjetër për të shlyer frekuentimin e detyruar, para përfundimit të semestrit. Në rastet e përsëritjes së mungesave, studenti i ndjek ato në vitin pasardhës.

Neni 8. *Kalimi në vitin pasardhës*

1. Studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë nëse ai ka marrë jo më pak se 30 kredite. Studenti i vitit të dytë kalon në vitin e tretë, nëse ai ka marrë jo më pak se 80 kredite. Studenti i vitit të tretë kalon në vitin e katërt, nëse ai ka marrë jo më pak se 140 kredite. Studenti i vitit të katërt kalon në vitin e pestë, nëse ai ka marrë jo më pak se 200 kredite.
2. Studenti që nuk plotëson kriteret për të kaluar në vitin pasardhës, ka këto të drejta e detyrime për lëndët jokaluese:
 - a. i njihen të gjitha detyrimet e shlyera kur programet e lëndëve përkatëse janë të pranueshme për vitin në vazhdim;
 - b. mund të frekuentojë lëndët për të cilat është vlerësuar mbetës dhe është i detyruar të frekuentojë lëndët për të cilat ka detyrim frekuentimin;
 - c. duhet të shlyejë detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimit të planit e programeve mësimore, nëse ka detyrim frekuentimi lëndë që janë zëvendësuar në këtë plan me lëndë të reja;
 - d. duhet të paguajë tarifën e shkollimit.

Neni 9. *Përmirësimi i notës*

1. Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës. Një veprim i tillë lejohet kur nota që kërkon të përmirësojë studenti është e një lënde të vitit akademik që ai sapo ka mbyllur. Studenti ka të drejtë të përmirësojë deri në dy nota në vit.
2. Për përmirësimin e notës, studenti provohet vetëm një herë dhe vetëm në sesionin e vjeshtës. Mbetet në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund. Në rast se studenti nuk paraqitet, mbetet në fuqi nota e sesionit të mëparshëm.
3. Kërkesa për përmirësim note i paraqitet dekanit jo më vonë se një javë pas përfundimit të sesionit të verës. Në bazë të vendimit që merr dekani, sekretaria mësimore kryen veprimet përkatëse.
4. Studenti mund të përmirësojë vetëm vlerësimin e marrë në provim, i cili i bashkëngjitet vlerësimit të marrë në elementët e tjerë të lëndës, përgjatë vitit shkollor.
5. Në rastin e organizimit të lëndëve me module, ku vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara ose shlyerjes së lëndës me pjesë, përmirësimi i notës bëhet për të gjithë lëndën.

KREU IV. *ORGANIZIMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE*

Neni 1. *Praktika profesionale*

1. Në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “*Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*”, praktika profesionale është e parashikuar me një ngarkesë prej 10 kreditesh. Procedurat e zhvillimit të saj janë në përputhje me përcaktimet e rregullores së zhvillimit kurrikular të UPT- së.
2. Këshilli i Programit të Studimit (KPS) dhe Koordinatori i Programit të studimit, janë përgjegjës për evidentimin, angazhimin dhe zgjerimin e databazës së kompanive / institucioneve për realizimin e Praktikave Profesionale. Koordinatori i KPS-së përditëson databazën e kompanive / institucioneve që ka bashkëpunim dhe ja dërgon elektronikisht një muaj para fillimit të praktikës drejtuesit të Departamentit të Urbanistikës. Praktikave profesionale zhvillohen në kompani / institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga Departamenti i Urbanistikës.
3. Departamenti i Urbanistikës mban përgjegjësi për kryerjen e praktikës profesionale. Drejtuesi i Departamentit përcakton pedagogët përgjegjës të cilët do të drejtojnë praktikën profesionale. Pedagogu përgjegjës përpilon “Programin e praktikës” i cili miratohet nga Drejtuesi i Departamentit.
4. Departamenti bën ndarjen e studentëve nëpër kompani / institucione pritëse, duke respektuar edhe propozimet e tyre. Lista e studentëve me pedagogun përgjegjës dhe kontratat e praktikës profesionale (bazuar në modelin-tip të dërguar nga drejtoria juridike e institucionit) i dërgohen për firmë Dekanit të fakultetit. Në rast kur kompania / institucioni pritës angazhohet për herë të parë në praktikë profesionale Rektori i UPT së lidh marrëveshje bashkëpunimi, deri një javë para fillimit të praktikës.
5. Studentët kanë detyrimin e kryerjes 100% të orëve të praktikës profesionale. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e kompanisë / institucionit pritës.
6. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, pedagogu përgjegjës që e drejton atë, mban lidhje me kompaninë / institucionin ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer i cili vlerësohet nga komisioni i ngritur në departament. Vlerësimi bëhet me notë.
7. Në rastet kur studenti për arsye objektive nuk shlyen detyrimet për praktikën mësimore, Departamenti, mbështetur në kërkesën e studentit (depozituar në Departament) mund t’i japi të drejtën për ri kryerjen e praktikës mësimore deri në fund të vitit akademik.

KREU V. MODALITETE PËR TRANSFERIMIN E STUDENTËVE

Neni 1. *Transferimi i studimeve*

1. Procedurat për transferimin e studimeve fillojnë në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë së fundi i javës së dytë të semestrit të parë.
2. Njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Arkitekturë - profili Urbanist”, bëhet nga Departamenti i Urbanistikës, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT dhe rregullores së Departamentit të Urbanistikës.
3. Kuotat në dispozicion për transferimin e studentëve dhe programe të dyta studimi nga brenda UPT-së ose IAL-ve të tjera përbëhen nga kuotat e paplotësuara nga regjistrimet e vitit të mëparshëm dhe kapacitetet që mund të krijohen, si rezultat i çregjistrimit të studentëve gjatë vitit akademik.
4. Lënda në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Arkitekturë - profili Urbanist” ekuivalentohet kur:
 - a. ka emërtim të njëjtë ose të ngjashëm me lëndën/modulin e programit të studimit ku transferohet;
 - b. trajton tema të njëjta ose të ngjashme dhe ka përputhje të ngarkesës në auditor në masën mbi 70% të lëndës / modulit që zhvillohet në programin e studimit në UPT.
5. Studenti mund të transferojë studimet, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UPT-së apo nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, nëse:
 - a. ka grumbulluar, sipas formulës së pranimit në programin përkatës të studimit, sasi pikësh më të larta se pragu minimal i pikëve, që është arritur në programin e studimit të kërkuar në vitin përkatës;
 - b. ka fituar jo më pak se 30 kredite në programin përkatës të studimit, nga vjen;
 - c. plotëson kriteret specifike për transferimin e studimeve të përcaktuara nga Departamenti i Urbanistikës ose Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës.
 - d. Në të kundërt, ai mund të fillojë studimet nga e para, duke ndjekur procedurat në hyrje të përcaktuara në kreun III të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT.
6. Vendimi për njohjen e plotë të krediteve të fituara nga një student që transferohet, i takon komisionit *ad hoc* të propozuar nga Departamenti i Urbanistikës dhe të miratuar nga drejtuesi i njësive kryesore.

Neni 2. *Njohja e krediteve për procese mësimore jashtë programit të studimit*

1. Njohja e krediteve të marra nga një student, jashtë programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Arkitekturë - profili Urbanist”, në kuadër të bashkëpunimeve institucionale ndërkombëtare apo kombëtare (programet Erasmus+ etj.) bëhet nga Departamenti i Urbanistikës, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT dhe Rregullores së Departamentit të Urbanistikës.

KREU VI. DIPLOMIMI

Neni 1. *Procedurat*

1. Procedurat e kryerjes së procesit të diplomimit në këtë program studimi respektojnë përcaktimet e rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Rregullores së Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës si dhe Rregullores së Departamentit të Urbanistikës.

2. Në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist”, lënda Studio Diplome zhvillohet në semestrin e 10-të të vitit të V-të të studimeve.

Neni 2. *Parakushte të marrjes së temës së Diplomës*

Studenti duhet të ketë fituar minimumi 255 kredite ECTS, nga të cilat 180 ECTS nga tre vitet e para dhe 75 ECTS nga viti i katërt dhe i pestë) në mënyrë që të mund të marrë temën e diplomës dhe të vijojë të ndjekë Studion e Diplomës në semestrin e 10-të. Studenti mund të mbartë vetëm një lëndë profesionale të tipit Studio.

Neni 3. *Aspekte didaktike*

1 kredit diplome në programin e studimit MSHA Urbanist zëbërthehet në 5 orë në auditor dhe 20 orë punë individuale.

Orë gjithsej në auditor për 15 kredite janë: $15 \text{ ECTS} \times 5 \text{ orë/ECTS} = 75 \text{ orë}$

Orë Javore të zhvilluara nga Studio e Diplomës: $75 \text{ orë} / 12 \text{ javë} = 6.25 \text{ orë/javë}$

Neni 4. *Punimi i diplomës*

1. Punimi i diplomës përmban një sërë detyrash e kërkesash, mënyra e shtrimit e të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore e projektuese, të tregojë aftësitë e tij profesionale dhe kompetencën për të kryer studime e projekttime në fushën e Arkitekturës dhe Urbanistikës.

2. Teza e diplomës është e lidhur me disa disiplina të përafërta dhe mund të jetë individuale ose kolektive (dy-tre studentë), në rastet e tezave studimore komplekse. Në rastet e punimeve kolektive, studentët kanë të ndarë çështjet që do të trajtojnë, duke respektuar një ndarje afërsisht të barabartë të volumit të punës që do të kryejnë.

3. Temat e diplomës dhe personelin akademik përkatës që do të udhëheqin punimet e diplomave, miratohen nga Departamenti i Urbanistikës, si përgjegjës i programit të studimit. Në përcaktimin e fushave të kërkimit të temave të diplomës, Departamenti i Urbanistikës mund bashkëpunojë me institutet kërkimore shkencore të UPT-së, si dhe me institucione të tjera, publike apo private.

4. Diplomantët paraqesin për miratim kërkesat me temat e propozuara (bazuar në fushat e kërkimit shkencor të DU) si dhe udhëheqësin në Departamentin e Urbanistikës, përmes formularëve të shpallur nga Departamenti, sipas njoftimeve përkatëse..

Formulari i propozimit të temës dhe udhëheqësit përmban argumentimin e propozimi, këndvështrimi i diplomantit dhe pritshmërinë në realizimin e temës. Ky dokument duhet të jetë i firmosur nga diplomanti dhe udhëheqësi. Në Aneksin 3 të kësaj rregulloreje gjenden formularët D1 dhe D2.

5. Studenti ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë, si dhe udhëheqësin e tij. Ai mund të propozojë edhe një tezë tjetër diplome së bashku me udhëheqësin përkatës. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale, pa cenuar nivelin e cilësinë e punimeve të diplomave.

6. Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur tezën e diplomës, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës në Studion e Diplomës dhe ka kryer kontrollet në DU.

7. Studenti nuk mund të mbrojë tezën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit.

Neni 5. Udhëheqja e temës së diplomës

1. Udhëheqja e temës së diplomës në FAU kryhet nga departamentet përkatëse. Udhëheqësi dhe Studioja e Diplomës janë përgjegjës për ecurinë dhe mbarëvajtjen e temës dhe procesit të diplomimit.
2. Diplomanti zgjedh një Udhëheqës në Departament ose jashtë tij, i cili miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Udhëheqësi duhet të shprehë pëlqimin për udhëheqjen në formularin përkatës.
3. Udhëheqësi i temës së diplomës duhet të ketë të paktën titullin Doktor. Në raste të veçanta, kur nuk mund të sigurohet mbulimi i plotë i të gjithë diplomantëve nga personel akademik me titullin e nevojshëm, përkohësisht do të japin kontribut të gjithë anëtarët e Departamentit të Urbanistikës.
4. Udhëheqësi, nuk mund të udhëheqë njëkohësisht më shumë se 15 studentë në një vit akademik.
5. Udhëheqësi i temës së diplomës *përgatit programin e punës* së diplomantit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të përfundimit të çdo pike të programit. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilit konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studenti.
6. Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe *miraton punimin e kryer* nga studenti. Ai jep mendimin e tij me shkrim, ku deklarohet realizimi i programit të punës të tezës së diplomës, niveli cilësor, elementët e punës krijuese të studentit dhe lejimi i mbrojtjes së punimit. Formulari i vlerësimit të udhëheqësit gjendet në Aneksin 4.

Neni 6. Detyrimet përmbyllëse të Diplomës

1. Diploma në programin *Master i Shkencave në Arkitekturë - Profili Urbanist*, zhvillohet në semestrin e X dhe është e organizuar si lëndë studio/atelie në grupe pune me 15-30 diplomantë të asistuar dhe mbikëqyrur nga 2-4 pedagogë. Atelietë aktivizohen nga Departamenti i Urbanistikës në varësi të numrit të studentëve që do ta frekuentojnë. Kjo studio kryen aktivitetin e saj sipas programit dhe planit mësimor. Çdo javë studenti paraqet ecurinë e punës së tij në Studion e Diplomës.
2. Studio e Diplomës ka për qëllim të:
 - a. Miratojë temën e diplomës,
 - b. Miratojë programin e punës së diplomantit,
 - c. Të asistojë udhëheqjen e diplomës,
 - d. Të vendosë kritere specifike për tema diplome me kompleksitet apo përmbajtje të veçantë,
 - e. Të rekomandojë literaturën për thellimin teorik,
 - f. Të mbikëqyrë çdo javë ecurinë e diplomës,
 - g. Të rekomandojë ndryshime nëse gjykohet e nevojshme,
 - h. Të ofrojë konsulencë të specializuar në fusha specifike,
 - i. Të organizojë tre kontrole të diplomës.
3. Me fillimin e semestrit të X studentët dorëzojnë në Departamentin e Urbanistikës formularin D1 për regjistrimin në Atelietë e Diplomës, në vijim të njoftimeve me afatet përkatëse nga DU.
4. Studenti është i detyruar të frekuentojë 75% të seancave në Atelienë e studios së Diplomës përkatëse.
5. Studenti duhet të shlyejë 2 kontrollet K1 dhe K2 brenda procesit mësimor të Studios së Diplomës.
6. Në rast mos përmbushjeje të kushteve me sipër, studenti duhet të frekuentojë Studion e Diplomës në vitet pasardhëse akademike.

Neni 7. *Kontrollet e ndërmjetme në Atelienë e Diplomave dhe përmbajtja e tyre*

1. Studio e Diplomës organizon *tre kontrolle periodike*, në të cilat kontrollohet volumi i punës së kryer dhe cilësia e saj.

Kontrolli i I (K1) i diplomës organizohet në javën e 3-të të semestrit të X.

Kontrolli i II (K2) i diplomës organizohet në javën e 12-të të semestrit të X.

Kontrolli i III (K3) organizohet gjatë sezonit të diplomimit të përcaktuar në kalendarin e strukturës mësimore për vitin akademik përkatës.

Në fillim të Studios së Diplomës, diplomantët do të njihen me kalendarin kontrolleve dhe aktivitetit akademik në këtë lëndë, të cilat për arsye të tjera, mund të pësojnë ndryshime nga sa më sipër.

2. Departamenti i Urbanistikës përcakton datat e zhvillimit të kontrolleve periodike duke respektuar programin mësimor, kalendarin e strukturës mësimore për vitin akademik dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje. Drejtuesi i Departamentit të Urbanistikës ngre komisione me 3-4 anëtarë në çdo kontroll diplome.

3. Anëtarët e Komisionit plotësojnë dhe nënshkruajnë procesverbalin përkatës për vlerësimin e studenteve për secilin kontroll periodik, i cili depozitohet në Departament.

Komisioni i kontrollit jep rekomandime mbi punimin e diplomës të cilat duhet të merren parasysh nga studenti dhe udhëheqësi i tij.

4. Studenti i cili nuk mund të shlyejë *K1* në javën e 3-të, mund ta shlyejë atë në javën e 12-të.

Studenti që nuk mund të shlyejë *K2* në javën e 12-të, mund t'a shlyejë atë në datën e *Kontrollit të III* që zhvillohet në sezonin e diplomimit të verës.

5. Studenti që nuk mund të shlyejë dy kontrollet e para (K1 dhe K2) brenda procesit mësimor të Studios së Diplomës duhet të frekuentojë këtë studio në vitin pasardhës.

6. Studenti që nuk mund të shlyejë *kontrollin e tretë* (K3) brenda procesit mësimor të Studios të Diplomës, mund ta shlyejë atë në sesionin e vjeshtës si dhe në sesionet e kontrolleve K3 të vitit akademik pasardhës (deri në sesionin e vjeshtës). Nëse kontrolli i tretë nuk shlyhet as në këto sesione, studenti duhet të marrë një temë të re dhe të frekuentojë Studion e Diplomës në vitin në vijim.

7. Përmbajtja e kontrolleve si dhe kalendarin e aktiviteteve të Studios së Diplomës përcaktohen në programin mësimor të lëndës.

Neni 8. *Mbrojtja e diplomës*

1. Studenti mund të mbrojë temën e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet dhe ka fituar *285 ETCS* të parashikuara në planin mësimor të programit përkatës të studimit.

2. Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur diplomën, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës, ka ndjekur Studion e Diplomës dhe ka shlyer të *tre kontrollet periodike* të detyrueshme.

3. Drejtuesi i departamentit plotëson fletën e kontrollit të tezës së diplomës, në të cilën regjistrohen kontrollet e kryera dhe vlerësimet me fjalë për secilën prej tyre.

4. *Kriteret e Diplomimit janë:*

- a. Frekuentimi në Studion e Diplomës,
- b. Shlyerja e tre kontrolleve të diplomës,
- c. Vlerësimi pozitiv nga Udhëheqësi,
- d. Vlerësimi pozitiv nga Recensenti,

- e. Miratimi nga Dekani i FAU,
- f. Mbrojtja e tezës së diplomës.

5. Studenti, para mbrojtjes së punimit të diplomës, duhet të ketë likuiduar të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me universitetin, bibliotekën shkencore, bibliotekën kombëtare, konviktet, etj.

6. Rregullat e pranimit dhe dorëzimit (formati dhe standardet) të tezës së diplomës, me përmbajtje projekt ose temë teorike-studimore, përcaktohen nga Departamenti i Urbanistikës bazuar në standardet dhe rregullat akademike, dhe do të mundësohet në fillim të çdo viti akademik.

Neni 9. *Organizimi i mbrojtjes së diplomës*

1. Universiteti Politeknik i Tiranës organizon 3 (tre) sesione për mbrojtjen e diplomave: në verë, vjeshtë dhe dimër. Sesionet shpallen nga rektori i UPT-së, në strukturën mësimore të vitit akademik. Datat e zhvillimit të mbrojtjes, sipas sesioneve përkatëse, propozohen nga Drejtuesi i Departamentit të Urbanistikës dhe miratohen nga drejtuesi i FAU.

2. Teza e diplomës mbrohet para një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personeli akademik i FAU si dhe profesionist të shquar të fushës (në qoftë se shihet e nevojshme), i cili propozohet nga Drejtuesi i Departamentit të Urbanistikës dhe i miratohet nga Dekani i FAU.

3. Komisioni i mbrojtjes së diplomave funksionon kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit.

4. Numri i anëtarëve të komisionit të mbrojtjes së diplomave është 5 (pesë) -7 (shtatë).

5. Mbrojtja e diplomës është publike.

Neni 10. *Vlerësimi i punimit*

1. Vlerësimi i tezës së diplomës, në përfundim të mbrojtjes së saj, është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Secili nga anëtarët ka në dispozicion një vlerësim nga 0-100 pikë. Rezultati përfundimtar i diplomës përlllogaritet në bazë të mesatares aritmetike të vlerësimit të gjithë anëtarëve. Vlerësimi me notë bëhet sipas pikëzimit:

100 - 95	<i>pikë</i>	<i>vlerësohet me notë përfundimtare</i>	10 (dhjetë)
94 - 85	<i>pikë</i>	<i>vlerësohet me notë përfundimtare</i>	9 (nëntë)
84 - 75	<i>pikë</i>	<i>vlerësohet me notë përfundimtare</i>	8 (tetë)
74 - 65	<i>pikë</i>	<i>vlerësohet me notë përfundimtare</i>	7 (shtatë)
64 - 55	<i>pikë</i>	<i>vlerësohet me notë përfundimtare</i>	6 (gjashtë)
54 - 45	<i>pikë</i>	<i>vlerësohet me notë përfundimtare</i>	5 (pesë)
nën 44	<i>pikë</i>	<i>vlerësohet me notë negative</i>	4 (katër)

2. Nota regjistrohet në procesverbalin e mbrojtjes së diplomave. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit.

3. Në përfundim të çdo seance mbrojtjeje, në mënyrë publike, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo diplomanti notën me të cilën është vlerësuar punimi i tij.

4. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative në mbrojtjen që i bën tezës së tij të diplomës, ai mund mbrojtje përsëri të njëjtën tezë ose, të mbrojtje një tezë të re në një afat kohor prej 3 vite akademike, pa tejkalluar afatin maksimal të përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi.

5. Gjatë periudhës tre vjeçare nga koha e përfundimit të studimeve të plota, diplomanti ka të drejtë të mbrojtje tezën e tij deri në dy herë.

6. Nëse rastet e *pikës 4* dhe *5* diplomanti vlerësohet nga komisioni me notë negative, ose ai nuk paraqitet për të bërë mbrojtjen e punimit, brenda afateve maksimale, studenti humbet të drejtën e diplomimit.

KREU VII. ANKIMIMI

Neni 1. *Ankimimi*

1. Çdo student/staf akademik ka të drejtë të ankimohet lidhur me:
 - a. standardet dhe cilësinë e mësimdhënies;
 - b. shkeljen e procedurave/rregullores ndaj tij, nga personeli akademik ose ai administrativ;
 - c. çdo problem tjetër akademik apo etik;
 - d. vlerësimin në format e ndryshme të kontrollit të dijeve si dhe në vlerësimin përfundimtar të lëndës.
2. Studenti nuk mund të apelojë vendimin e komisionit të diplomimit/provimi i formimit, pasi ai është i pakthyeshem.
3. Departamenti i Urbanistikës do të respektojë procedurat për zgjidhjen e ankesave, brenda fushës së saj të përgjegjësisë:
 - a. në rastet e ankesave në lidhje me vlerësimin e rezultatit të provimit, ndiqet procedura e përcaktuar në nenin 35 të Rregulloren për Zhvillimin Kurrikular dhe Mësimdhënien në UPT;
 - b. në rastet kur ankesat kanë lidhje me standardet dhe cilësinë e mësimdhënies, shkeljen e rregullave akademike, probleme të tjera të procesit mësimor, ankimuesit mund t'i drejtohen drejtuesit të Departamentit të Urbanistikës, ose drejtuesit të Njesisë Kryesore;
 - c. në rastet kur ka shkelje të kodit të etikës, ankesa mund t'i drejtohet Këshillit të Etikës së UPT-së.
 - d. procedurat e ankimimit përcaktohen në nenin 75 të Rregullores për Zhvillimin Kurrikular dhe Mësimdhënien në UPT.

KREU VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Çdo çështje që lind nga zbatimi i kësaj rregulloreje dhe nuk mbulohet prej saj, rregullohet me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT. Në rast se edhe kjo e fundit nuk e mbulon, atëherë Departamenti i Urbanistikës i drejton Rektorit dhe Senatit Akademik propozimin përkatës për miratim.
2. Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka *Asambleja e Departamentit të Urbanistikës*.
3. *Rregullorja mësimore e programit të studimit* hartohet/rishikohet nga Këshilli i Programit të Studimit të Njesisë Bazë dhe miratohet në Departamentin e Urbanistikës dhe në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës. Ajo është objekt rishikimi periodik. Rishikimi bëhet para fillimit të vitit të ri akademik dhe synon të përmirësohen dhe përditësohen elementë të ndryshëm të saj.

Asambleja e Departamentit të Urbanistikës

Tiranë më, 09.09.2022

DREJTUESI I DEPARTAMENTIT TË URBANISTIKËS
Dr. Juljan VELESHNJA



ANEKS 1. *PLANI MËSIMOR*



MIRATUAR

Kryetari i SAUPT

Prof. Dr. Andrea MALIQARI

ANEKS 1a

PLANI MËSIMOR - MASTER I SHKENCAVE NË ARKITEKTURË

Profili Urbanist

Vitit akademik 2022-2023

1/2

Table with university and department information: UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS, FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS, DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS, PROGRAMI I STUDIMIT: MASTER I SHKENCAVE NË ARKITEKTURË, PROFILI: URBANIST, AFATI I STUDIMIT: 5 VITE, DETYRIME PËRMBYLLËSE: DIPLOMË / 15 ECTS

Table showing structure and credit distribution by semester: Nr, Struktura e vitit mësimor, Javet sipas viteve (I-V), Shuma

Main course plan table with columns for course ID, name, category, ECTS credits, and various semester/week breakdowns (Viti i Parë, Viti i Dytë, Viti i Katërt, Viti i Pestë)

Hartuar nga Departamenti i Urbanistikës

Drejtuuesi i Departamentit të Urbanistikës Dr. Julian VELESHNJA

Vlerësimi

- P Provim
D Diplomë
PR Praktike
X Pa vlerësim per semestrin

Dekani i Fakultetit Prof. Dr. Armand Vokshi



MIRATUAR

Kryetari i SAUPT

Prof. Dr. Andrea MALIQARI

ANEKS 1a

PLANI MËSIMOR - MASTER I SHKENCAVE NË ARKITEKTURË

Profili Urbanist

Vitit akademik 2022-2023

2/2

Table with university and department information: UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS, FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS, DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS, PROGRAMI I STUDIMIT: MASTER I SHKENCAVE NË ARKITEKTURË, PROFILI: URBANIST, AFATI I STUDIMIT: 5 VITE, DETYRIME PËRMBYLLESE: DIPLOMË / 15 ECTS

Summary table of courses by semester: Columns include Nr, Struktura e vitit mësimor, Javët sipas viteve (I-V), and Shuma. Total sum is 260.

Main course schedule table with columns for course ID, name, category, ECTS, audit hours, and semester breakdown (Viti i Parë to Viti i Pestë).

Hartuar nga Departamenti i Urbanistikës

Drejtuuesi i Departamentit të Urbanistikës Dr. Juljan VELESHNJA

Vlerësimi

- P Provim
D Diplomë
PR Praktike
X Pa vlerësim per semestrin

Dekani i Fakultetit Prof. Dr. Armand Vokshi



ANEKS 1 a

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS
PROGRAMI I STUDIMIT: MASTER I SHKENCAVE NË ARKITEKTURË
PROFILI: URBANIST
AFATI I STUDIMIT: 5 VITE
DETYRIME PËRMBYLLËSE: DIPLOMË / 15 ECTS

PLANI MËSIMOR - MASTER I SHKENCAVE NË ARKITEKTURË

Profili Urbanist

Viti akademik 2022-2023

1/2

Table with 6 columns: Nr, Struktura e vitit mesimor, and 5 columns for semesters (I-V), plus a total column (Shuma).

Main curriculum table with columns for course ID, name, category, ECTS, and detailed semester breakdown (Semestri i Parë, Semestri i Dytë, etc.)

Hartuar nga Departamenti i Urbanistikës

Drejtuesi i Departamentit të Urbanistikës Dr. Julian VELESHNJA

Vlerësimi

- P Provim
D Diplome
PR Praktike
X Pa vleresim per semestrin



Dekani i Fakultetit Prof. Dr. Armand Vokshi



ANEKS 2. *EKUIVALENTIME*

ANEKS 2

Programi studimit M.SH. Arkitekturë - profili Urbanist					Viti akademik, para 2018-2019					
Viti akademik, 2022-2023					Viti akademik, para 2018-2019					
Plani mësimor MSH Arkitekturë - profili Urbanist					Ekuivalentim	Lëndët dhe notat e marra në studimet e mëparshme				
	Kat.	ETCS	ETCS	Viti		Sem		Kat.	ETCS	
Viti I										
Semestri i parë (14 javë mësim)										
1	MT111AU	Matematikë 1	A	3	3	1	1	Matematikë 1	A	3
2	GJH11DU	Gjuhë e huaj	D	5	5	1	1	Gjuhë e Huaj	E	6
3	GJ111AU	Gjeometri deskriptive 1	A	5	5	1	1	Gjeometri Deskriptive 1	A	5
4	VHA11AU	Vizatim i lirë dhe histori arti	A	6	6	1	1	Bazat e Grafikës e Modelimit	A	6
5	MND11CU	Materiale ndërtimi	C	3	3	1	1	Materiale Ndërtimi	B	3
6	GAR10AU	Grafikë arkitektonike	A	4	8	1	1	Bazat e Vizatimit (projektimit)	B	7
6	GAR10AU	Grafikë arkitektonike	A	4						
7	AQT11BU	Analizë qyteti dhe territori	B	4				NUK EKUIVALENTOHET		
Totali I / I				34	30					
Semestri i dytë (14 javë mësim)										
8	MT212AU	Matematikë 2	A	3	3	1	2	Matematikë 2	B	3
9	HA112DU	Histori arkitekture 1	A	6	6	1	2	Histori Arkitekture 1	B	7
10	GJ212AU	Gjeometri deskriptive 2	A	4	4	1	2	Gjeometri Deskriptive 2	A	4
11	BPA12AU	Bazat e projektimit arkitektonik	B	8	8	1	2	Bazat e Projektimit Arkitektonik	B	7
12	END12CU	Elemente ndërtesash	A	5	5	1	2	(Materiale) Elemente Ndërtesash	B	5
Totali I / II				26	26					
Totali I				60	56	56				

ANEKS 2

Programi studimit M.SH. Arkitekturë - profili Urbanist					Viti akademik, 2022-2023						
Viti akademik, 2022-2023					Viti akademik, para 2018-2019						
Plani mësimor MSH Arkitekturë - profili Urbanist					Ekivalentim	Lëndët dhe notat e marra në studimet e mëparshme					
			Kat.	ETCS	ETCS	Viti	Sem			Kat.	ETCS
Viti II											
Semestri i parë (14 javë mësim)											
13	GC121AU	Komunikim grafik - CAAD1	A	3	3	2	3	CAAD-Vizualizim Grafik 1	A	3	
14	HA221AU	Histori arkitekture 2	A	5	5	2	3	Histori Arkitekture 2	B	4	
15	KFH20BU	Kompozicion, analizë forme e hapësire	B	4	4	2	3	Kompozicion, Analizë Forme e Hapësire	B	4	
16	SA121BU	Studio arkitekture 1	B	8	8	2	3	Studio Arkitekture 1	B	8	
17	TA121BU	Teknologji arkitekture 1	B	5	5	2	3	Teknologji Arkitekture 1	B	5	
18	SK121CU	Shkencë konstruksioni 1	C	5	5	2	3	Shkencë Konstruksioni 1	C	6	
Totali II / I				30	30						
Semestri i dytë (14 javë mësim)											
19	GC222AU	Komunikim grafik - CAAD 2	A	3	3	2	4	CAAD-Vizualizim Grafik 2	A	3	
20	HA322AU	Histori arkitekture 3	A	3	3	2	4	Histori Arkitekture 3	B	3	
15	KFH20BU	Kompozicion, analizë forme e hapësire	B	4	4	2	4	Kompozicion, Analizë Forme e Hapësire	B	4	
21	SA222BU	Studio arkitekture 2	B	8	8	2	4	Studio Arkitekture 2	B	7	
22	TA222BU	Teknologji arkitekture 2	B	5	5	2	4	Teknologji Arkitekture 2	B	4	
23	BUP22BU	Bazat e projektimit urban dhe elemente të peizazhit	B	7	7	3	6	Sistemim Gjellbërim	C	9	
Totali II / II				30	30						
Totali II				60	60						

ANEKS 2

Programi studimit M.SH. Arkitekturë - profili Urbanist										
Viti akademik, 2022-2023					Viti akademik, para 2018-2019					
Plani mësimor MSH Arkitekturë - profili Urbanist					Ekuivalentim	Lëndët dhe notat e marra në studimet e mëparshme				
			Kat.	ETCS	ETCS	Viti	Sem		Kat.	ETCS
Viti III										
Semestri i parë (14 javë mësim)										
24	TAU31BU	Teori arkitekture e urbanistike	B	6	6	3	5	Teori Arkitekture e Urbanistike	B	5
						3	6	Teori Arkitekture e Urbanistike	B	4
25	SA331BU	Studio arkitekture 3	B	8	8	3	5	Studio Arkitekture 3	B	8
26	TA331BU	Teknologji arkitekture 3	B	6	6	3	5	Teknologji Arkitekture 3	B	7
27	FTK31AU	Fizikë teknike	A	6	6	3	5	Fizikë Ambientale	B	6
28	SK231CU	Shkencë konstruksioni 2	C	4	4	3	5	Shkencë Konstruksioni 2	C	4
Totali III / I				30	30					
Semestri i dytë (14 javë mësim)										
29	RAT32BU	Rilevim arkitektonik dhe topografi	B	4	4	1	2	Topografi	C	4
30	SA432BU	Studio arkitekture 4	B	8	8	3	6	Studio Arkitekture 4	B	7
31	URB32BU	Urbanistikë 1	B	8	8	2	4	Urbanistikë 1	B	9
32	IND32CU	Impiante ndërtesash	C	6	6	3	6	Impiante Ndërtesash	C	6
33	KN132CU	Konstruksione ndërtimi 1	C	4	4	3	6	Konstruksione Ndërtimi 1	C	4
Totali III / II				30	30					
Totali III				60	60					

ANEKS 2

Programi studimit M.SH. Arkitekturë - profili Urbanist					Viti akademik, para 2018-2019						
Viti akademik, 2022-2023					Viti akademik, para 2018-2019						
Plani mësimor MSH Arkitekturë - profili Urbanist					Ekivalentim	Lëndët dhe notat e marra në studimet e mëparshme					
			Kat.	ETCS	ETCS	Viti	Sem			Kat.	ETCS
Viti IV											
Semestri i parë (12 javë mësim)											
34	PMU40BU	Projektim i mjedisit të ndërtuar	B	4	4	4	7	Projektim Ambiental	C	4	
35	HUR41BU	Histori urbanistike	B	6	6	4	7	Histori Urbanistike	B	6	
36	PLT41BU	Planifikim territori	B	6	6	4	7	Planifikim Territorial	C	6	
37	PU240BU	Projektim urbanistik 2	B	8	8	4	7	Projektim Urbanistik 2	B	8	
38	LAU41CU	Legjislacion arkitektonik e urban	C	3	3	4	7	Legjislacion Arkitektonik e Urban	C	3	
39	GJU41BU	Gjeografi urbane	B	3	3	4	7	Gjeografi Urbane	C	3	
Totali IV / I				30	30						
Semestri i dytë (12javë mësim)											
34	PMU40BU	Projektim i mjedisit të ndërtuar	B	4	4	4	8	Projektim Ambiental	C	4	
40	TRI42BU	Transport dhe Infrastrukturë	B	6	6	4	8	Transport Infrastrukture	B	6	
37	PU240BU	Projektim urbanistik 2	B	6	6	4	8	Projektim Urbanistik 2	B	6	
41	ETU42CU	Ekonomi tregu dhe ekonomi urbane	C	6	6	4	8	Ekonomi Tregu + Ekonomi Urbane	C	6	
42	Z1S42CU	Lëndë me zgjedhje 1:	C	4	4	4	8	Lëndë me zgjedhje:	E	4	
	Z1P42CU	Sociologji urbane						1. Sociologji Urbane			
	Z1K42CU	Politika urbane dhe territoriale						NUK EKUIVALENTOHET			
	Z1K42CU	Kërkim shkencor dhe etikë profesionale						2. Kërkim Shkencor + Etikë Profesionale			
43	MUR42BU	Menaxhim urban	B	4	4	5	9	Menaxhim Urban	B	4	
Totali IV / II				30	30						
Totali IV				60	60	60					

ANEKS 2

Programi studimit M.SH. Arkitekturë - profili Urbanist					Viti akademik, 2022-2023						
Viti akademik, 2022-2023					Viti akademik, para 2018-2019						
Plani mësimor MSH Arkitekturë - profili Urbanist					Ekuivalentim		Lëndët dhe notat e marra në studimet e mëparshme				
			Kat.	ETCS	ETCS	Viti	Sem			Kat.	ETCS
Viti V											
Semestri i parë (12 javë mësim)											
44	ELP51BU	Elemente Peizazhi	B	5	5	5	9	Elemente Peizazhi	B	6	
45	RUR51BU	Rigjenerim Urban	B	7	7	5	9	Projektim Urbanistik 3 (Rivitalizim Urban)	B	8	
46	MKA51BU	Metoda kërkimore të aplikuara në Urbanistikë	B	4	4	5	9	Diploma Arkitekt, profili Urbanist	F	5	
47	FAQ51CU	Filozofi dhe antropologjia e qytetit	C	5				NUK EKVIVALENTOHET			
48	GIS51DU	Sisteme Informacioni (G.I.S)	D	4	4	5	10	CAAD + Sisteme Informacioni (G.I.S)	C	5	
49	PST51BU	Politikat e strehimit - Housing	B	5	5	5	9	Politikat e Strehimit	B	4	
						5	9	Rrjete Inxhinierike Nëntokesore	C	3	
Totali V / I				30	25						
Semestri i dytë (12 javë mësim)											
50	DPL52EU	Diploma Urbanist	E	15	15	5	10	Diploma Arkitekt, profili Urbanist	F	25	
51	Z2T52CU	Lëndë me zgjedhje 2:	C	5							
	Z2Q52CU	Teori Bashkëkohore te urbanizimit dhe politikat sociale						NUK EKVIVALENTOHET			
	Z2U52CU	Hapësirat publike dhe dizajni urban						NUK EKVIVALENTOHET			
52	PPR52DU	Praktikë profesionale	D	10		4	8	Praktikë Profesionale NUK EKVIVALENTOHET	D	4	
Totali V / II				30	15						
Totali V				60	40						
Total				300	276						
										60	
											300



ANEKS 3. FORMULARË APLIKIMI STUIO DIPLOME, D1, D2

TEMA E DIPLOMËS _ MSHA Profili Urbanist

D1 _ Formular propozimi për temën e diplomës dhe udhëheqësin

dep.urb@fau.edu.al

STUDENTI

Emri: Mbiemri:

Firma:.....

Programi i studimit: MSH Arkitekturë (Urbanist)

E-mail: Tel.

TEMA E PROPOZUAR E DIPLOMËS

Temë studimore Projekt (shëno me X)

Titulli:

UDHËHEQËSI I TEZËS SË DIPLOMËS

Emri: Mbiemri:

Profesioni: Grada / Titulli:

E-mail: Tel:

(e-mail dhe nr.tel. kur udhëheqësi nuk është staf i FAU)

PRANOHET PROPOZIMI I TEMËS SË DIPLOMËS

Data:.....

Drejtuesi i Departamentit

Emri/Mbiemri: Firma:.....

STUDENTI

Emri:

Mbiemri:

Firma:.....

UDHËHEQËSI I TEZËS SË DIPLOMËS

Emri:

Mbiemri:

Firma:

MIRATOHET TEMA E DIPLOMËS / UDHËHEQËSI

Data e Kontrollit të parë:

Studio e Diplomës, komisioni i Ateliesë:

Emri/Mbiemri:

Firma:.....

Emri/Mbiemri:

Firma:.....

Emri/Mbiemri:

Firma:.....

Emri/Mbiemri:

Firma:.....



ANEKS 4. *FORMAT VLERËSIMI UDHËHEQËSI I DIPLOMËS*

DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS
PROGRAMI I STUDIMIT M.SH. NË ARKITEKTURË, PROFILI URBANIST

VLERËSIMI I UDHEHEQËSIT
PËR PUNIM DIPLOME

TEMA:

Studenti:

Udhëheqësi:

<i>Procesi</i>	Vlerësimi	Po	Pjesërisht	Jo
<i>Analiza</i>	Analiza e gjendjes ekzistuese dhe programi i parashtruar janë të qartë dhe të arritshëm			
<i>Metodologjia</i>	Puna është ndërtuar mbi baza metodologjike			
	Vendimmarrja mbështetet në një analize të thelluar			
<i>Frekuentimi</i>	Diplomanti është konsultuar vazhdimisht			
<i>Propozimi</i>	Propozimi i paraqitur përmban risi			
	Propozimi konceptual mbështetet mbi baza teorike			
	Propozimi përmbush objektivat në aspektin sasior dhe cilësor			
	Propozimi teknik është i qartë dhe i hollësishëm			
<i>Paraqitja</i>	Materiali i paraqitur është i mjaftueshëm për të ilustruar qartë dhe saktë propozimin			
	Relacioni respekton kriteret e shkrimit akademik			
<i>Dorëzimi</i>	Studenti është i gatshëm të dorëzojë e mbrojë diplomën			

Komente të tjera:

.....

.....

.....

.....

Tiranë, më: ____ . ____ . ____

Udhëheqësi:

Emër Mbiemër Firmë